

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË  
NR. \_\_\_ REP. 2576  
NR. \_\_\_ KOL. 996



## AKT THEMELIM

### I

## SHOQËRISË ANONIME "RAIFFEISEN LEASING" sh.a.

Sot, më datë 28.09.2006 në Tiranë, përpara meje Noteres Znj. **Mimoza Sadushi**, Notere e Dhomës së Noterëve, Tiranë, u paraqitën përfaqësuesit e palëve të mëposhtme:

**Raiffeisen Bank sh.a.**, një bankë e themeluar dhe që është organizuar, në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën Rruga Kavajes, Tirana, Shqipëri, përfaqësuar nga **Z. Steven Grunerud**, në cilësinë e tij si përfaqësues ligjor (më poshtë referuar si, "RBAL"); dhe

**Raiffeisen - Leasing International Gesellschaft m.b.H.**, një shoqëri e themeluar dhe që është organizuar, në bazë të ligjeve të Austrisë, me seli në Am Stadtpark 9, 1030 Vienë, Austri, përfaqësuar nga Znj. **Rudina Ziu**, në cilësinë e saj si përfaqësuese ligjore (këtu e më poshtë referuar si "RLI").

Unë, Noteri, pasi studiova dokumentacionin e paraqitur nga palët dhe/ose përfaqësuesit e tyre, vërtetoj se përfaqësuesit e palëve të mësipërme janë madhorë me zotësi të plotë për të vepruar dhe se palët e mësipërme janë krijuar dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre rregullisht. Me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, palët kanë kërkuar të hartohet Akti I Themelimit si më poshtë vijon në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe kanë rënë dakort me tekstin e këtij dokumenti sipas kushteve dhe termave të mëposhtëm.

### I. Dispozita të Përgjithshme

- § 1. Emërtimi i Shoqërisë është "Raiffeisen-Leasing" sh.a." (më poshtë referuar si "Shoqëria").
- § 2. Selia e Shoqërisë është në: Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri.
- § 3. Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.
- § 4. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Asambleja e Aksionareve mund të krijojë ose të mbyllë dege dhe/ ose filiale në Shqipëri dhe jashtë saj.
- § 5. Aksionerët themelues të Shoqërisë janë:
  - a) **Raiffeisen Bank sh.a.**, Tirana, Albania;
  - b) **Raiffeisen - Leasing International Gesellschaft m.b.H.**, Vienë, Austri;

## II. Objekti i Shoqërisë

### § 6. 1. Objekti i Shoqërisë është:

- a) ushtrimi I veprimtarisë së qirasë financiare, qiradhënia financiare e sendeve të luajshme dhe pasurive të paluajshme, dhe
- b) blerja e sendeve me qëllim rishitjen e tyre, dhe
- c) financimi ose kredidhënia në funksion të veprimtarisë së qirasë financiare, dhe
- d) Të gjitha veprimtaritë e tjera të biznesit të lidhura apo plotësuese, të cilat mund të jenë të nevojshme (duke përfshirë ndër të tjera, shërbime regjistrimi, ndërmjetësim në sigurime, menaxhim ndërtimesh dhe të infrastrukturave që lidhen me to për pasuri të paluajshme ose kryerja e shërbimeve të tjera që lidhen me objektet e dhëna në qira financiare).

2. Nëse Shoqëria angazhohet në një aktivitet i cili kërkon një leje, miratim apo licensë, Drejtoria duhet të aplikojë për certifikimin përkatës.

### § 7. Shoqëria ka të drejtën të themelojë filiale ose dege brenda vendit dhe të blejë pjesëmarrje në çfarëdolloj mënyre ligjore në shoqëri të tjera tregtare, si dhe të realizojë projekte tregtare së bashku me subjekte të tjera tregtare.

## III. Kapitali aksionar dhe aksionet

### § 8. 1. Kapitali I Shoqërisë është 123 000 000 ALL (Lekë Shqiptare) (njëqind e njëzetetë milionë lekë) ose 1 000 0000 Euro (një milionë Euro) dhe ndahet në 1000 (njëmijë) aksione me vlerë nominale prej 123 000 ALL (njëqind e njëzet e tre mijë lekë) secila ose 1 000 Euro (njëmijë Euro) secila. Cdo aksion është I pandashëm dhe përbën të drejtën e një vote.

2. Secili prej aksionarëve mund të zotërojë më shumë se një aksion.

3. Ndarja e aksioneve midis aksionarëve është si më poshtë:

- a) **RBAL: 750** aksione (shtatëqind e pesëdhjetë) me vlerë nominale 92 250 000 ALL (nëntëdhjetë e dy milionë dyqind pesëdhjetë mijë lekë) ose 750 000 Euro (shtatëqind pesëdhjetë mijë).
- b) **RLI: 250** aksione (dyqind e pesëdhjetë) me vlerë nominale 30 750 000 ALL (tridhjetëmilionë shtatëqind e pesëdhjetë mijë Lekë) ose 250 000 Euro (dyqind pesëdhjetë mijë).

### § 9. Aksionet mund të transferohen në përputhje me ligjet ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara në Statut.

## IV. Organet e Shoqërisë

### § 10. 1. Shoqëria përbëhet nga organet e mëposhtme:

- a) Asambleja e Aksionarëve;
- b) Këshilli Mbikqyrës;

c) Drejtoria.

2. Kompetencat, funksionimi dhe organizimi i organeve te Shoqerise rregullohet ne Statutin e saj.

#### **Asambleja e Aksionarëve**

Asambleja e Aksionarëve mund të jetë e zakonshme dhe e jashtëzakonshme dhe thirret në mbledhje nga Këshilli Mbikqyrës ose nga Drejtoria, ose sipas parashikimeve ligjore ne fuqi.

#### **Këshilli Mbikqyrës**

§ 12. 1. Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 (tre) deri në 12 (dymbëdhjetë) anëtarë. 2/3 (dy të tretat) e anëtarëve zgjidhen nga Asambleja e Aksionarëve. 1/3 (një e treta) e anëtarëve të tij zgjidhet nga punonjësit e shoqërisë, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Anëtarët e Këshillit të parë Mbikqyrës emërohen nga Asambleja e Aksionarëve. Kohëzgjatja e mandatit të tyre është 3 (tre) vjet nga dita e emërimit në detyrë.

2. Anëtarët e Këshillit të parë Mbikqyrës janë zgjedhur personat e mëposhtëm kohëzgjatja e mandatit të të cilëve në këtë detyrë është 3 (tre) vjet:

1. **Z. Dieter Schiedl**, shtetas austriak, lindur në Gmuend, Austri, më 11.09.1967, banues në Huglgasse 11/7, 1150 Vienë, Austri, me pas. N. A 0087535;
2. **Z. Steven Grunerud**, shtetas kanadez, lindur në Vankuver, Kanada, më 03.04.1963, banues në Tiranë, Shqipëri, me pas. N. BC16338;
3. **Z. Robert Wright**, shtetas anglez, lindur në Birkenhead, Angli, më 25.10.1956, banues në Tiranë, Shqipëri, me pas. N. 093121379.

#### **VII. Drejtoria**

§ 13. 1. Drejtoria përbëhet nga nje ose më shumë anëtarë, të cilët emërohen nga Këshilli Mbikqyrës për një mandat jo më të gjatë se katër vjet; rizgjedhja është e lejueshme. Anëtarët e Drejtorisë mund të shkarkohen nga funksioni i tyre prej Këshillit Mbikqyrës. Këshilli Mbikqyrës emëron Kryetarin e Drejtorisë dhe gjithashtu, një zv. Kryetar nga anëtarët e emëruar.

2. Shoqëria do të përfaqësohet ligjërisht tek të tretët nga Kryetari i Drejtorisë, ose në mungesë të tij nga Zv. Kryetari i Drejtorisë. Në rast se Drejtoria përbëhet nga një Drejtor, ky i fundit do të ketë të drejtën e përfaqësimit të Shoqërisë tek të tretët.

3. Për transaksionet financiare në lidhje me veprimtarinë e qirasë financiare Shoqëria do të përfaqësohet bashkarisht nga një anëtar i Drejtorisë dhe një nëpunës i autorizuar për të nënshkruar në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Rregullat në lidhje me të drejtën e nënshkrimit në emër dhe për llogari të Shoqërisë do të përcaktohen nga Këshilli Mbikqyrës.

4. Drejtoria e parë e Shoqërisë përbëhet nga një Drejtor, kohëzgjatja e mandatit të të cilit është 4 (katër) vjet.

5. **Znj. Majlinda Hakani**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 27.05.1967, banuese në Tiranë, në adresën Rr. Muhamet Gjollësia, Pall. 56/1/7, pas. N. 0777898; është emëruar Drejtore e Shoqërisë dhe për sa kohë që Drejtoria e Shoqërisë do të përbëhet nga një Drejtor, **Znj. Hakani** do të ketë të gjitha kompetencat dhe do të kryejë të gjitha detyrat që Statuti i Shoqërisë ka parashikuar për Drejtorinë, Kryetarin dhe Zv. Kryetarin e Drejtorisë.

6. **Znj. Hakani** nëpërmjet këtij akti ngarkohet të kryejë të gjithë procedurat e nevojshme për rregjistrimin e Shoqërisë si person juridik në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dhe për rregjistrimin e saj në organet perkatese fiskale. Ajo autorizohet të përfaqësojë Shoqërinë përpara të gjithë organeve gjyqësore, personave fizike dhe/ose personave juridike dhe/ose institucioneve publike për përmbushjen e detyrave të ngarkuara me siper dhe të nënshkruajë aktet e nevojshme në lidhje me to. **Znj. Hakani** ka të drejtë të emerojë avokate nëpërmjet një prokure noteriale duke i autorizuar ata të kryejnë veprimet e nevojshme për përmbushjen e detyrave ngarkuar asaj nëpërmjet këtij akti.

## VIII. Kontrollorët

- § 14. Kontrolli i brendshëm i Shoqërisë kryhet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të emëruar për një vit ushtrimor.
- § 15. Kontrollore e Shoqërisë është zgjedhur shoqëria e të drejtës shqiptare **KPMG Albania sh.p.k.**

## IX. Likuidimi dhe Mbyllja

- § 16. Shoqëria konsiderohet e mbyllur në rast se vërtetohen faktet e parashikuara nga ligji. Në rast mbyllje, Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionarëve zgjedh një ose më shumë likuidatorë dhe u jep atyre kompetencat përkatëse.
- § 17. Shoqëria mund gjithashtu të shpërndalet apo të bashkohet me një tjetër me vendim të Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Aksionerëve.
- § 18. Ky Akt Themelimi është hartuar dhe rregullohet sipas legjislacionit shqiptar.
- § 19. Të gjitha kontradiktat që lindin ose që lidhen me interpretimin i këtij Akti Themelimi, ndërmjet Aksionarëve ose midis një ose më shumë Aksionarëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe të drejtpërdrejtë midis palëve.
- § 20. Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin për ose në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin, shkeljen, përfundimin ose pavlefshmërinë e këtij Akti Themelimi midis aksionarëve, një aksionari dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në bazë të Rregullave të Arbitrazhit dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të Qendrës së Arbitrazhit të Dhomës Federale Ekonomike Austriake, Vienë, prej tre arbitrave të emëruar në bazë të këtyre rregullave. Vendi i arbitrazhit do të jetë Viena, Austri dhe gjuha që do përdoret në procesin e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.

## X. Dispozita Përfundimtare

§ 21. Ky Akt Themelimi përpilohet në 10 (dhjetë) kopje, 5 (pesë) prej të cilave janë në Anglisht dhe 5 (pesë) në Shqip. Në rast të ndonjë konflikti midis versioneve në gjuhë Angleze dhe Shqipe, versioni në Anglisht do të jetë mbizotërues.

§ 22. Në lidhje me çështjet që nuk janë rregulluar në këtë Akt Themelimi, do të zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

\* \* \* \* \*

Unë Noteri pasi lexova këtë Akt Themelimi me zë të lartë Palëve të pranishme, jam e bindur se palët e gjejnë atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë dhe e firmosin lirisht para meje, dhe unë Noteri e vërtetoj atë sipas ligjit.

## AKSIONARËT

**Raiffeisen Bank sh.a.**

**Raiffeisen - Leasing International Gesellschaft m.b.H.**

**Z. Steven Grunerud**


**Znj. Rudina Ziu**

*Steven Grunerud*

*Rudina Ziu*

**NOTERE**

**Znj. Mimoza Sadushi**



**PERKTHYES**

**Znj. Edlira Cepani**

*Edlira Cepani*

*Edlira Cepani*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË  
NR. \_\_\_ REP. 2537  
NR. \_\_\_ KOL. 997



STATUTI  
I  
SHOQËRISË ANONIME "RAIFFEISEN LEASING" sh.a.

Sot, më datë 28.09.2006 në Tiranë, përpara meje Noteres Znj. **Mimoza Sadushi**, Notere e Dhomës së Noterëve, Tiranë, u paraqitën përfaqësuesit e palëve të mëposhtme:

**Raiffeisen Bank sh.a.**, një bankë e themeluar dhe që është organizuar, në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën Rruga Kavajes, Tirana, Shqipëri, përfaqësuar nga **Z. Steven Grunerud**, në cilësinë e tij si përfaqësues ligjor (më poshtë referuar si, "RBAL"); dhe

**Raiffeisen - Leasing International Gesellschaft m.b.H**, një shoqëri e themeluar dhe që është organizuar, në bazë të ligjeve të Austrisë, me seli në Am Stadtpark 9, 1030 Vienë, Austri, përfaqësuar nga Znj. **Rudina Ziu**, në cilësinë e saj si përfaqësuese ligjore (këtu e më poshtë referuar si "RLI").

Unë, Noteri, pasi studiova dokumentacionin e paraqitur nga palët dhe/ose përfaqësuesit e tyre, vërtetoj se përfaqësuesit e palëve të mësipërme janë madhorë me zotësi të plotë për të vepruar dhe se palët e mësipërme janë krijuar dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre rregullisht. Me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, palët kanë kërkuar të hartohet Statuti si më poshtë vijon në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe kanë rënë dakort me tekstin e këtij dokumenti sipas kushteve dhe termave të mëposhtëm.

**I. Dispozita të Përgjithshme**

- § 1. Emërtimi i Shoqërisë është "Raiffeisen-Leasing" sh.a." (më poshtë referuar si "Shoqëria").
- § 2. Selia e Shoqërisë është në: Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri.
- § 3. Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.
- § 4. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Asambleja e Aksionareve mund të krijojë ose të mbyllë filiale dhe/ose dege në Shqipëri dhe jashtë saj.
- § 5. Aksionerët themelues të Shoqërisë janë:
- a) **Raiffeisen Bank sh.a.**, Tirana, Albania;
  - b) **Raiffeisen - Leasing International Gesellschaft m.b.H**, Vienë, Austri;
- § 6. Përsa i përket marrëdhënieve ndërmjet Shoqërisë dhe aksionerëve, vendbanimi i secilit prej aksionerëve është ai që është vendosur në regjistrin e aksioneve.

## II. Objekti i Shoqërisë

### § 7. 1. Objekti i Shoqërisë është:

- a) ushtrimi I veprimtarisë së qirasë financiare, qiradhënia financiare e sendeve të luajtshme dhe pasurive të paluajtshme, dhe
- b) blerja e sendeve me qëllim rishitjen e tyre, dhe
- c) financimi ose kredidhënia në funksion të veprimtarisë së qirasë financiare, dhe
- d) Të gjitha veprimtaritë e tjera të biznesit të lidhura apo plotësuese, të cilat mund të jenë të nevojshme (duke përfshirë ndër të tjera, shërbime regjistrimi, ndërmjetësim në sigurime, menaxhim ndërtimelesh dhe të infrastrukturave që lidhen me to për pasuri të paluajtshme ose kryerja e shërbimeve të tjera që lidhen me objektet e dhëna në qira financiare).

2. Nëse Shoqëria angazhohet në një aktivitet i cili kërkon një leje, miratim apo licensë, Drejtoria duhet të aplikojë për certifikimin përkatës.

### § 8. Shoqëria ka të drejtën të themelojë filiale ose dege brenda vendit dhe të blejë pjesëmarrje në çfarëdolloj mënyre ligjore në shoqeri të tjera tregtare, si dhe të realizojë projekte tregtare së bashku me subjekte të tjera tregtare.

## III. Kapitali aksionar dhe aksionet

### § 9. 1. Kapitali I Shoqërisë është 123 000 000 ALL (Lekë Shqiptare) (njëqind e njëzetetrec milionë lekë) ose 1 000 0000 Euro (një milionë Euro) dhe ndahet në 1000 (njëmijë) aksione me vlerë nominale prej 123 000 ALL (njëqind e njëzet e tre mijë lekë) secila ose 1 000 Euro (njëmijë Euro) secila. Cdo aksion është I pandashëm dhe përbën të drejtën e një vote.

2. Secili prej aksionarëve mund të zotërojë më shumë se një aksion.


3. Ndarja e aksioneve midis aksionarëve është si më poshtë:

a) **RBAL: 750 aksione (shtatëqind e pesëdhjetë)** me vlerë nominale 92 250 000 ALL (nëntëdhjetë e dy milionë dyqind pesëdhjetë mijë lekë) ose 750 000 Euro (shtatëqind pesëdhjetë mijë).

b) **RLI: 250 aksione (dyqind e pesëdhjetë)** me vlerë nominale 30 750 000 ALL (tridhjetëmilionë shtatëqind e pesëdhjetë mijë Lekë) ose 250 000 Euro (dyqind pesëdhjetë mijë).

### § 10 1. Aksionet mund të transferohen në përputhje me ligjet dhe dispozitat e parashikuara në Statut.

2. Shoqëria duhet të mbajë një regjistër aksionesh në të cilin të figurojnë emri dhe mbiemri, ose emri i Shoqërisë, si dhe adresa e zotëruesit të një aksioni të regjistruar, shumën e pagesave të kryera për aksion, gjithashtu edhe njoftimet në lidhje me transferimin e këtij aksioni kundrejt palëve të treta, duhet të regjistrohen së bashku me datën e hyrjes.

- 
3. Çdo transferim i aksioneve të Shoqërisë duhet t'i nënshtrohet miratimit të aksionarëve. Transferimi *inter vivos* i aksioneve të Shoqërisë është objekt i të drejtës së parablerjes në favor të aksionarëve të tjerë, të cilët mund ta ushtrojnë këtë të drejtë brenda 20 ditëve nga data e letrës së dërguar me postë rekomande, e cila përmban ofertën përkatëse. Dispozitat e këtij Neni nuk zbatohen në lidhje me shitjet dhe transferimet e kryera ndërmjet aksionarëve. Sidoqoftë, në këtë rast, transferimi duhet t'i komunikohet paraprakisht me shkrim aksionarëve të tjerë. Të gjitha njoftimet e parashikuara në këtë Nen, duhet t'i dërgohen gjithashtu edhe Shoqërisë.
  4. Në rast të rritjes së kapitalit të Shoqërisë, aksionet e reja i ofrohen si opion aksionarëve të saj në proporcion me numrin e aksioneve që ata zotërojnë, për tu nënshkruar dhe paguar në bazë të ligjit.
  5. Forma dhe përmbajtja e certifikatave të aksioneve (ose certifikatave të përkohshme të aksioneve) duhet të përcaktohet me vendim të Drejtorisë në përputhje me ligjet në fuqi.
  6. Drejtoria mund të urdhërojë emetimin/lëshimin e një certifikate të re, në vend të cilësdo certifikatë të emetuar deri atëherë nga Shoqëria, e cila supozohet të ketë humbur ose të jetë shkatërruar. Kur autorizon emetimin e kësaj certifikate të re, përpara se ta emetojë atë, Drejtoria ka të drejtë të përcaktojë kushte dhe terma që i konsideron të arsyeshme, si dhe mund të kërkojë dëmshpërblime përkatëse nëse gjykon se janë të përshtashme për të mbrojtur Shoqërinë nga çdo deklaram që mund të jetë kundër saj, në lidhje me cilëndo prej këtyre certifikatave të cilat supozohet se kanë humbur ose janë shkatërruar.

#### **IV. Organet e Shoqërisë**

§ 11. Shoqëria përbëhet nga organet e mëposhtme:

- a) Asambleja e Aksionarëve;
- b) Këshilli Mbikqyrës;
- c) Drejtoria.

#### **V. Asambleja e Aksionarëve**

§ 12. Asambleja e Aksionarëve mund të jetë e zakonshme dhe e jashtëzakonshme dhe thirret në mbledhje nga Këshilli Mbikqyrës ose nga Drejtoria, ose sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

§ 13. Asambleja e Aksionarëve zhvillohet të paktën një herë në vit, si Asamble e zakonshme, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar.

§ 14. 1. Asambleja e Aksionarëve, duhet të thirret në mbledhje me anë të njoftimit dërguar me postë rekomande. Kjo letër duhet t'i dërgohet Aksionarëve në adresat që i kanë komunikuar Shoqërisë, të paktën dy javë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë. Njoftimi përmban datën, kohën dhe vendin e Mbledhjes së Aksionarëve, si dhe rendin e ditës të detajuar. Mbledhjet e Asamblesë zhvillohen në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër të përcaktuar në njoftim.

2. Mbledhja e Asamblesë është e vlefshme edhe nëse të gjithë aksionarët e Shoqërisë janë të pranishëm në Asamblesë e Aksionarëve dhe nëse asnjëri prej aksionarëve nuk ka



kundërshtime në lidhje me zhvillimin e Asamblesë ose në lidhje me përfshirjen e disa çështjeve në rendin e ditës.

§ 15. Vendimet e aksionarëve merren në Asamble. Nëse të gjithë aksionarët shprehin miratimin e tyre me shkrim në lidhje me vendimin që duhet të merret ose me votimin (duke përfshirë këtu nëpërmjet faksit, teleks-it dhe telegramit), vendimet mund të merren pa zhvilluar një mbledhje. Nëse këto kushte ekzistojnë, Asambleja e Aksionarëve zhvillohet në një vend në të cilin ndodhet si Presidenti, ashtu edhe Sekretari i mbledhjes, në mënyrë që të kryhet përpilimi dhe nënshkrimi i procesverbaleve të mbledhjes në regjistrin përkatës.

§ 16. 1. Vendimet e Asamblesë së Zakonshme të Aksionarëve janë të vlefshme kur 75% e aksionarëve me të drejtë vote janë të pranishëm personalisht ose të përfaqësuar me prokurë. Në rast se ky quorum nuk është i pranishëm, mbledhja me të njëjtin rend dite do të njoftohet për tu mbajtur jo më vonë se 2 (dy) muaj nga data e mbledhjes së parë. Asambleja e azhornuar do të marrë vendime me çfarëdolloj quorumi të pranishëm. Asambleja e azhornuar thirret në mbledhje në të njëjtën mënyrë sic është thirrur Asambleja e Zakonshme e Aksionarëve herën e parë. Vendimet e Asamblesë së Zakonshme të Aksionarëve merren me shumicën e votave që zotërojnë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar.

2. Vendimet e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionarëve, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar me prokurë 75 % e aksionarëve me të drejtë vote. Në rast se ky quorum nuk është i pranishëm, mbledhja me të njëjtin rend dite do të njoftohet për tu mbajtur jo më vonë se 2 (dy) muaj nga data e mbledhjes së parë. Asambleja e azhornuar do të marrë vendime kur është i pranishëm një quorum prej 25% e aksionarëve më të drejtë vote. Asambleja e azhornuar thirret në mbledhje në të njëjtën mënyrë sic është thirrur Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionarëve herën e parë. Vendimet e Asamblesë së Jashtëzakonshme merren me një shumicë votash prej  $\frac{3}{4}$  që zotërojnë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar.

§ 17. E drejta e votës në Asamblenë e Përgjithshme varet nga vlera e secilës prej aksioneve. Cdo aksion me një vlerë prej 123 000 Leke (*njëqind njëzet e tre mijë*) ose 1000 Euro (*njëmijë*) jep të drejtën e një vote.

§ 18. Aksionerët mund të ushtrojnë të drejtat e tyre të votës në Asamblenë e Aksionarëve me anë të pranishëm të tyre personale ose të përfaqësimit me prokurë. Prokura duhet të depozitohet në shoqëri përpara fillimit të Asamblesë dhe do të jetë e vlefshme për atë Asamble, si dhe për Asamblenë e azhornuar, në rast të mungesës së quorumit të aksionarëve të pranishëm në Asamblenë e parë.

§ 19. Përveç kompetencave të tjera që legjislacioni në fuqi parashikon për Asamblenë e Aksionarëve, kjo e fundit do të ketë kompetenca ekskluzive në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- a) ndryshimin ose plotësimin e këtij Satuti, duke përfshirë edhe ndryshimet në lidhje me objektin e Shoqërisë;
- b) rritjen ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- c) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës dhe dhënien e huave, bonove ose benefiteve të tjera anëtarëve;
- d) dëmshpërblime në favor të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës;

- e) emërimi i likuidatorëve;
- f) vendime në lidhje me riblerjen e aksioneve dhe vendosjen e rregullave bazë për këtë;
- g) vendosja e kushteve dhe termave për pagesën e detyrimeve të saj ndaj të tretëve (obligacioneve) ose instrumentave të tjera të borxhit;
- h) marrja e vendimeve në lidhje me çështje të tjera, nëse kërkohet nga dispozita të vecanta;
- l) miratimi i bilancit vjetor dhe marrja e vendimeve mbi shpërndarjen e fitimit vjetor, si dhe mbulimin e humbjeve;
- k) emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të Shoqërisë;
- m) marrjen e vendimeve mbi shkrijen, shndërrimin ose likuidimin e Shoqërisë.

§ 20 1. Kryetari i Asamblesë së Aksionarëve është përfaqësuesi ligjor i aksionarit të shumicës. Asambleja e Aksionarëve zgjedh një Sekretar për mbledhjen, i cili mund edhe të mos jetë aksionar.

2. Kryetari i Asamblesë së Aksionarëve drejton mbledhjen e Asamblesë së Aksionarëve. Ai nuk është i autorizuar të heqë ose të ndryshojë çështje nga rendi i ditës me diskrecionin e tij.

3. Procesverbalet e Asamblesë së Aksionarëve dhe vendimet përkatëse mbahen nga sekretari dhe nënshkruhen nga ai/ajo dhe nga Kryetari i Asamblesë së Aksionarëve. Procesverbalet mbahen në një regjistër të veçantë. Vendimet e Asamblesë së Aksionarëve duhet të mbahen në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Në rast të një konflikti ndërmjet versioneve në gjuhën Angleze dhe Shqipe, do të ketë përparësi versioni në gjuhën angleze.

§ 21. Anëtarët e Drejtorisë dhe të Këshillit Mbikqyrës marrin pjesë në Asamblenë e Aksionarëve në përmbushje të detyrave të tyre. Ekspertët Kontabël të Shoqërisë ftohen të marrin pjesë nëse prezenca e tyre është e nevojshme sipas rendit të ditës. Mungesa e të gjithë ose e disa anëtarëve të Drejtorisë, të Këshillit Mbikqyrës ose të eksperteve kontabël nuk e çënon vlefshmërinë e Asamblesë së Aksionarëve.

## VI. Këshilli Mbikqyrës

§ 22.1. Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 (tre) deri në 12 (dymbëdhjetë) anëtarë. 2/3 (dy të tretat) e anëtarëve zgjidhen nga Asambleja e Aksionarëve. 1/3 (një e treta) e anëtarëve të tij zgjidhet nga punonjësit e shoqërisë, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Anëtarët e Këshillit të parë Mbikqyrës emërohen nga Asambleja e Aksionarëve. Kohëzgjatja e mandatit të tyre është 3 (tre) vjet nga dita e emërimit në detyrë.

2. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës emërohet për një kohë jo më të gjatë se tre vjet; Riemërimi në këtë detyrë është i lejueshëm. Kryetari dhe Zv.Kryetari i Këshillit Mbikqyrës emërohen nga Këshilli Mbikqyrës, ndër anëtarët e tij me një shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të këtij organi. Ata zgjidhen për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit të tyre dhe në përfundim të tij kanë të drejtë të rizgjidhen.

3. Anëtarët e Këshillit të parë Mbikqyrës janë zgjedhur personat e mëposhtëm kohëzgjatja e mandatit të të cilëve në këtë detyrë është 3 (tre) vjet:

1. **Z. Dieter Schiedl**, shtetas austriak, lindur në Gmuend, Austri, më 11.09.1967, banues në Huglgasse 11/7, 1150 Vienë, Austri, me pas. N. A 0087535;
2. **Z. Steven Grunerud**, shtetas kanadez, lindur në Vankuver, Kanada, më 03.04.1963, banues në Tiranë, Shqipëri, me pas. N. BC16338;
3. **Z. Robert Wright**, shtetas anglez, lindur në Birkenhead, Angli, më 25.10.1956, banues në Tiranë, Shqipëri, me pas. N. 093121379.

§ 23. 1. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të zgjedhur nga Asambleja e Aksionarëve, mund të shkarkohen për çfarëdolloj arsyeje nga vetë Asambleja e Aksionarëve. Anëtarët e zgjedhur nga punonjësit mund të shkarkohen sipas ligjit.

2. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës kanë të drejtë të japin dorëheqjen në çdo moment, pa qënë nevoja të deklarojnë arsyet e kësaj dorëheqjeje. Deklarata e dorëheqjes duhet t'i jepet Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës, ose në mungesë të tij, Zv.Kryetarit.

3. Në rast vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqjeje, anëtari duhet të zëvendësohet, brenda jo më shume se 3 (tre) muajve. Anëtari i Këshillit Mbikqyrës, i zgjedhur për të zëvendësuar një tjetër anëtar, do të qendrojë në detyrë përgjatë gjithë kohës së mbetur të mandatit të paraardhësit.

§ 24. 1. Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës thirren nga Kryetari i tij, ose në mungesë të tij, nga Zv.Kryetari, të paktën 3 (tre) herë në vit. Mbledhje të tjera të Këshillit mund të thirren sipas kërkesës të cilido prej anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës ose të Drejtorisë, duke specifikuar qëllimin e kësaj kërkesë.

2. Të gjitha mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës duhet të thirren dhe të njoftohen me postë rekomande ose me faks, duke specifikuar rendin e ditës. Njoftimi duhet të kryhet jo më vonë se dy javë përpara datës përkatëse të mbledhjes. Në raste urgjente, periudha e njoftimit për mbledhjen mund të jetë më pak se dy javë.

3. Vendimet e Këshillit Mbikqyrës mund të merren me shkrim edhe nepermjet faksit, telex-it, telegramit, postës elektronike dhe mjeteve të tjera të komunikimit, nëse të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës kanë deklaruar me shkrim miratimin e tyre për këtë mënyrë vendimmarrjeje. Nëse ekzistojnë këto kushte, Këshilli Mbikqyrës konsiderohet se mbledhet në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, në mënyrë që të kryhet përpilimi dhe nënshkrimi i procesverbalit në regjistrin përkatës.

4. Mbledhja e Këshillit Mbikqyrës zhvillohet në vendin ku ndodhet selia e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të përcaktuar në njoftim. Procesverbalet mbahen nga një sekretar i zgjedhur nga Këshilli për secilën mbledhje, dhe nënshkruhen nga ajo/ai dhe nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës. Sekretari mund të jetë edhe një person që nuk është anëtar i Këshillit. Procesverbalet mbahen në një regjistër të veçantë. Procesverbalet përpilohen në Anglisht dhe në Shqip. Në rast të një konflikti ndërmjet versioneve në gjuhën Angleze dhe Shqipe, do të ketë përparësi versioni në Anglisht. Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës do të zhvillohen në Anglisht.

§ 25. Këshilli Mbikqyrës nuk mund të marrë vendime të vlefshme nëse nuk janë të pranishëm të paktën ½ e anëtarëve të tij. Vendimet e Këshillit Mbikqyrës duhet të merren me unanimitet nga anëtarët e Këshillit Mbikqyrës që marrin pjesë në votim. Në rast të numrit të votave të barabarta, vota e Kryetarit është vendimtare.

§ 26. 1. Këshilli Mbikqyrës emëron, pezullon ose shkarkon anëtarët e Drejtorisë dhe lidh ose përfundon kontratat e punës, si dhe, nëse aplikohet, lidh ose përfundon kontrata pensioni me anëtarët e Drejtorisë.

2. Këshilli Mbikqyrës ka të drejtën të vendosë mbi çdo çështje që lidhet me marrëdhëniet ndërmjet një anëtari të Drejtorisë dhe Shoqërisë, duke përfshirë, por duke u kufizuar jo vetëm në, përcaktimin e autoritetit të tyre, zgjatjen e kredisë së dhënë nga Shoqëria, dorëheqjen, daljen në pension etj, me përjashtim të shkarkimit ose heqjes dorë nga detyrimi.

§ 27. Këshilli Mbikqyrës kontrollon të gjitha aktivitetet e Shoqërisë. Kontrollon zbatimin e Statutit dhe të çdo dispozite përkatëse ligjore në lidhje me organet e Shoqërisë. Këshilli Mbikqyrës ka të drejtën të inspektojë llogaritë e Shoqërisë, librin e llogarive, regjistrat dhe të gjithë administrimin e saj. Këshilli Mbikqyrës duhet të kontrollojë dhe të verifikojë bilancet vjetore dhe përputhjen e tyre me llogaritë e Shoqërisë dhe regjistrat përkatës, si dhe me gjendjen aktuale; gjithashtu do të kontrollojë dhe verifikojë raportet e biznesit, si dhe propozimet e Drejtorisë dhe do të japë vërejtjet e tij mbi bilancin vjetore, raportet e biznesit dhe propozimet e Asamblesë së Aksionarëve.

§ 28. Këshilli Mbikqyrës duhet të miratojë rregullat e tij të brendshme, të cilat duhet të specifikojnë mënyrën e përmbushjes së detyrave të veta dhe zhvillimin e aktiviteteve të tij.

§ 29. Të gjitha deklaratat që do të përpilohen për Këshillin Mbikqyrës ose që do të merren nga ai, do të konsiderohen të vlefshme nëse do të bëhen ose do të merren nga Kryetari i tij, ose në mungesë, nga Zv.Kryetari. Kjo zbatohet në veçanti për deklaratimet që duhet të përpilohen ose të merren *vis-a-vis* nga Drejtorja.

§ 30. Anëtarët e Drejtorisë kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës, por ata nuk kanë të drejtë vote. Sidoqoftë, Kryetari ka të drejtë, të thërrasë një mbledhje të Këshillit Mbikqyrës, pa pjesëmarrjen e njërit ose të gjithë anëtarëve të Drejtorisë.

§ 31. Procesverbalet e Këshillit Mbikqyrës duhet t'i dërgohen aksionarëve, anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, si dhe anëtarëve të Drejtorisë.

§ 32. Këshillit Mbikqyrës duhet të mblidhet menjëherë pas emerimit të tij nga Asambleja e Aksionarëve për të zgjedhur Kryetarit e Këshillit Mbikqyrës. Kjo mbledhje e Këshillit Mbikqyrës zhvillohet pa ndonjë procedurë të veçantë.

## VII. Drejtorja

§ 33. 1. Drejtorja përbëhet nga një ose më shumë anëtarë, të cilët emërohen nga Këshilli Mbikqyrës për një mandat jo më të gjatë se katër vjet; rizgjedhja është e lejueshme. Anëtarët e Drejtorisë mund të shkarkohen nga funksioni i tyre prej Këshillit Mbikqyrës. Këshilli Mbikqyrës emëron Kryetarin e Drejtorisë dhe gjithashtu, një zv. Kryetar nga anëtarët e emëruar.

2. Këshilli Mbikqyrës mund të vendosë shpërblim për anëtarët e Drejtorisë në momentin e emerimit të tyre.

3. Në rast të një vendi të lirë për shkak vdekje, dorëheqje, shkarkimi, mos-kualifikimi apo ndonjë shkak tjetër, pasardhësi që do të plotësojë vendin e lirë duhet emëruar nga Këshilli Mbikqyrës në mbledhjen e tij të parë pas krijimit të vendit të lirë. Pasardhësi do të përfundojë mandatin e personit të cilin ai do të zëvendësojë. Nëse shumica e anëtarëve të Drejtorisë japin dorëheqjen, supozohet se e tërë Drejtoria ka dhënë dorëheqjen dhe si pasojë Këshilli Mbikqyrës duhet të procedojë menjëherë për caktimin e Drejtorisë së re.

§ 34

Drejtoria drejton Shoqërinë në pajtim me ligjin, këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Aksionerëve dhe vendimet e Këshillit Mbikqyrës. Drejtoria vendos për të gjitha aktivitetet e Shoqërisë, përveçse kur këto aktivitete janë kompetencë e Asamblesë së Aksionarëve ose e Këshillit Mbikqyrës.

§ 35.

Drejtoria duhet të marrë miratimin paraprak të Këshillit Mbikqyrës për:

1. vendimet për strategjinë e Shoqërisë, si për shembull vendime mbi:
  - a) strategjinë e përgjithshme të biznesit duke përfshirë vendimet për tregjet, rrugët e shitjeve (degët e RBAL, agjentët e shitjeve, bashkëpunimet me palët shitëse) dhe bashkëpunimet me RBAL në përgjithësi;
  - b) buxhetin strategjik (pesë vjeçar) dhe materialet ndihmëse të Shoqërisë dhe filialeve të saj;
  - c) bashkëpunimin me palë të treta ose shpërndarjen e funksioneve të biznesit të Shoqërisë kundrejt palëve të treta, duke përfshirë dhe krijimin e shoqërive të përbashkëta;
  - d) prezantimi i një produkti të ri (nëpërmjet një rritjeje të konsiderueshme të një produkti ekzistues, por që për shkak të peshës së tij në portofolin e përgjithshëm konsiderohet si prezantim i një produkti të ri);
  - e) buxheti vjetor, duke përfshirë planin vjetor të financimit, planin e investimeve, kufizimet e portofolit dhe materialet mbështetëse të Shoqërisë dhe çfarëdolloj ndryshimi për paralogaritje ose tejkalime të investimeve prej saj;
2. vendime për Drejtorinë e Shoqërisë, për shembull vendime mbi:
  - a) miratimin dhe modifikimin e rregulloreve të Drejtorisë së Shoqërisë;
  - b) dhënien e borxheve, bonove dhe benefiteve të tjera për Drejtorinë e Shoqërisë;
  - c) dhënien dhe anulimin e të drejtave të përfaqësuesve në bazë të një prokure noteriale;
3. vendime të Shoqërisë për manaxhimin e riskut të kredisë, për shembull të:
  - a) autoritetet e miratimit të riskut të kredisë së Shoqërisë (Autoriteti Autonom i Miratimit);
  - b) proceset e miratimit të riskut të kredisë brenda Shoqërisë;
  - c) miratimin e limitit të kredisë për shuma më të larta se ato të Autoritetit Autonom të Miratimit;
  - d) strategjitë e zhvillimit;
4. vendimet mbi riskun e menaxhimit të tregut të shoqërisë p.sh. vendimet mbi:
  - a) miratimet e kufirit të riskut të tregut;
  - b) miratimet për të përdorur instrumentat financiarë të derivuar (të deleguara, opsione, shkëmbime dhe të instrumente të ngjashme);

5. vendimet mbi rifinancimin e Shoqërisë p.sh. vendimet mbi;
- a) marrjen e huave dhe mjeteve të tjera financiare të cilat e tejkalojnë planin vjetor të fondeve të miratuara;
  - b) kalimin ose shitjen e të ardhurave prej qirasë financiare për t'u vjelë në të ardhmen ( blerjen e borxheve, strukturat ABS) pavarësisht nga shuma.

6. vendimet mbi degët e shoqërisë p.sh. vendimet mbi;
- a) ushtrimin e të drejtave të tjera të aksionarit në Filiale;
  - b) ndonjë ndryshim ose mosvazhdim i Biznesit të Filialeve dhe/ose zhvillimi i ndonjë aktiviteti përveç aktiviteteve të Shoqërisë nga një Filial, duke përfshirë, por jo vetëm, likuidimin dhe mbylljen e ndonjë pjesë të Biznesit të Filialit;
  - c) shpërndarjen e funksioneve të biznesit të Shoqërisë tek Filialet;
  - d) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të Filialit;
  - e) miratimin dhe ndryshimin e rregulloreve për organet e Filialeve;
  - f) blerjen, disponimin dhe hipotekimin e Pasurive të paluajtshme të Filialeve;

7. dhënia e huave, bonove dhe benefiteve të tjera për të punësuarit e Shoqërisë;

8. blerja, disponimi dhe hipotekimi i pasurive të paluajtshme të Shoqërisë nëse akoma nuk janë miratuar në dokumentin e miratimit të kufirit të rrezikut të kredisë;

9. çdo çështje tjetër përtej zhvillimeve të zakonshme të biznesit ose të një rëndësisë të madhe për Shoqërinë dhe për Filialet.

§ 36. Drejtoria do të veprojë në përputhje me çfarëdolloj rregulloreje, udhëzimi dhe kërkesë të vendosur nga Këshilli Mbikqyrës herë pas here. Dispozitat për kryerjen e detyrave menaxhuese të Drejtorisë do të parashikohen në rregulloren e Drejtorisë që do të miratohet nga Këshilli Mbikqyrës.

§ 37. Për vendimet e Drejtorisë është i nevojshëm një quorum (prania) e të gjithë anëtarëve. Megjithatë, nëse janë të pranishëm më shumë se dy anëtarë të Drejtorisë do të jetë i nevojshëm vetëm një quorum i përbërë prej shumicës së thjeshtë të anëtarëve. Drejtoria do të vendosë në mënyrë unanime; nëse nuk arrihet ndonjë vendim në mënyrë unanime, Drejtoria do të raportojë menjëherë çështjen tek Këshilli Mbikqyrës i cili ka të drejtë të vendosë dhe të udhëzojë Drejtorinë.

38. Drejtoria do të mbledhet të paktën një herë në muaj në selinë e Shoqërisë se në ndonjë vend tjetër, në Shqipëri ose jashtë, dhe mbledhjet e saj mund të zhvillohen gjithashtu nëpërmjet videokonferencës, ose me anën e mjeteve elektronike të tjera të ngjashme, me kushtin që pjesëmarrësit të identifikohen dhe t'u jetë krijuar mundësia të ndjekin diskutimet dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në të. Nëse ekzistojnë kushte të tilla, Drejtoria mbahet në vendin ku ndodhen Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, në mënyrë që të kryhet hartimi dhe firmosja e procesverbalit në regjistrin përkatës.

39. Kryetari thërret në mbledhje Drejtorinë, duke përcaktuar rendin e ditës, në çdo kohë që ai e konsideron të nevojshme ose në rastin kur merr një kërkesë me shkrim nga të paktën një anëtar i Drejtorisë ose i Këshillit Mbikqyrës. Kërkesa duhet të përmbajë listën e çështjeve ose subjekteve të cilëve u drejtohet. Nëse Kryetari refuzon të thërrasë një mbledhje dy ditë pas marrjes së kërkesës, mbledhja mund të thirret nga personi që ka kërkuar mbledhjen. Drejtoria do të thirret në mbledhje me anë të një letre rekomande, telegrami ose faksi të dërguar të paktën 3(tre) ditë para mbledhjes: në raste urgjente

mbledhja duhet të thirret një ditë para datës së caktuar për mbledhjen. Në rast se Kryetari mungon ose për arsye të tjera është i paafët të marrë pjesë në mbledhje, të gjitha funksionet e përmendura në këtë nen do t'i delegohen zëvendës Kryetarit, nëse ka, ose anëtarit më të vjetër. Mbledhja e Drejtorisë do të jetë e vlefshme edhe nëse njoftimi formal i thirrjes nuk ndodh, me kusht që të gjithë anëtarë të jenë të pranishëm.

40. Drejtoria mund të caktojë një Sekretar për të mbajtur procesverbalet dhe t'i vërtetojë ato me anën e firmës së tij së bashku me Kryetarin ose në rast se ai mungon, me një nga anëtarët e pranishëm. Sekretari mund të jetë edhe një person i cili nuk është anëtar i Drejtorisë. Procesverbalet mbahen në një regjistër të veçantë.

41. Procesverbali i mbledhjes së Drejtorisë do të mbahet në gjuhën shqipe dhe angleze dhe do të firmosen nga të gjithë anëtarët e Drejtorisë. Në rast mospërputhjeje midis versionit anglisht dhe shqip, versioni anglisht do të ketë përparësi.

42. Perfaqësimi i Shoqërisë:

1. Shoqëria do të përfaqësohet ligjërisht tek të tretët nga Kryetari i Drejtorisë, ose në mungesë të tij nga Zv. Kryetari i Drejtorisë. Në rast se Drejtoria përbëhet nga një Drejtor, ky i fundit do të ketë të drejtën e përfaqësimit të Shoqërisë tek të tretët.
2. Për transaksionet financiare në lidhje me veprimtarinë e qirasë financiare Shoqëria do të përfaqësohet bashkarisht nga një anëtar i Drejtorisë dhe një nëpunës i autorizuar për të nënshkruar në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Rregullat në lidhje me të drejtën e nënshkrimit në emër dhe për llogari të Shoqërisë do të përcaktohen nga Këshilli Mbikqyrës.
3. Drejtoria e parë e Shoqërisë përbëhet nga një Drejtor, kohëzgjatja e mandatit të të cilit është 4 (katër) vjet.
4. **Znj. Majlinda Hakani**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 27.05.1967, banuese në Tiranë, në adresën Rr. Muhamet Gjollësja, Pall. 56/1/7, pas. N. 0777898; është emëruar Drejtore e Shoqërisë dhe për sa kohë që Drejtoria e Shoqërisë do të përbëhet nga një Drejtor, **Znj. Hakani** do të ketë të gjitha kompetencat dhe do të kryejë të gjitha detyrat që ky Statut ka parashikuar për Drejtorinë, Kryetarin dhe Zv. Kryetarin e Drejtorisë.

## VIII. Administrimi i biznesit dhe llogaritë vjetore

§ 43. Viti financiar i Shoqërisë do të jetë viti kalendarik.

§ 44. Brënda tre muajve të parë të çdo viti financiar, Drejtoria duhet t'i paraqesë Këshillit Mbikqyrës llogaritë vjetore (duke përfshirë edhe bilancin dhe llogaritë fitim/humbje) për vitin financiar paraardhës të audituar nga ekspertë kontabël të autorizuar, një propozim për shpërndarjen dhe/ose për mënyrë tjetër përdorimi të fitimeve ose mbulimit të humbjeve, si dhe raportin vjetor të Shoqërisë. Të gjithë llogaritë vjetore dhe dokumentet e tjera të përmendura më sipër duhet të përpilohen sipas legjisllacionit shqiptar në fuqi si dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare.

§ 45. 1. Dividentët duhet të shpërndahen sipas vlerës së çdo aksioni. Dividentët që duhet t'i jepen aksionarëve të cilët janë rezidentë jashtë shtetit, sipas kërkesës së tyre, këmbehen

në monedhën e shtetit të aksionarëve, dhe/ose në ndonjë monedhë tjetër të këmbyeshme e cila është kërkuar nga aksionari në përputhje me ligjet e zbatueshme.

2. Përveç rasteve kur Asambleja e Aksionarëve ka vendosur ndryshe, dividendët duhet të shpërndahen brenda tre ditësh nga vendimi i Asamblesë që ka vendosur për ndarjen e tyre.

§ 46. 5% e fitimeve neto që rezultojnë nga bilanci i miratuar, sipas dispozitave ligjore kalojnë për rezervën ligjore derisa kjo shumë të arrijë vlerën 10% të kapitalit të Shoqërisë.

§ 47. Fitimet e mbetura shpërndahen sipas vendimeve të Asamblesë së Aksionarëve për shpërndarjen e dividendëve dhe zërave të tjerë.

## **IX. Kontrollorët**

§ 48. Kontrolli i brendshëm i Shoqërisë kryhet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të emëruar për një vit ushtrimor.

§ 49. Kontrollorët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme.

§ 50. Kontrollore e Shoqërisë është zgjedhur shoqëria e të drejtës shqiptare KPMG Albania sh.p.k.

## **X. Likuidimi dhe Mbyllja**

§ 51. Shoqëria konsiderohet e mbyllur në rast se verifikohen faktet e parashikuara nga ligji. Në rast mbyllje, Asambleja e jashtëzakonshme e Aksionarëve zgjedh një ose më shumë likuidatorë dhe u jep atyre kompetencat përkatëse.

§ 52. Shoqëria mund gjithashtu të shpërndahet apo të bashkohet me një tjetër me vendim të Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Aksionerëve.

§ 53. Ky Statut është hartuar dhe rregullohet sipas legjislacionit shqiptar.

§ 54. Të gjitha kontradiktat që lindin ose që lidhen me interpretimin i këtij Statuti, ndërmjet Aksionarëve ose midis një ose më shumë Aksionarëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe të drejtpërdrejtë midis palëve.

§ 55. Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin për ose në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin, shkeljen, përfundimin ose pavlefshmërinë e këtij Statuti midis aksionarëve, një aksionari dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në bazë të Rregullave të Arbitrazhit dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të Qendrës së Arbitrazhit të Dhomës Federale Ekonomike Austriake, Vienë, prej tre arbitrave të emëruar në bazë të këtyre rregullave. Vendi i arbitrazhit do të jetë Viena, Austri dhe gjuha që do përdoret në procesin e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.



## XI. Dispozita Përfundimtare

§ 56. Ky Statut përpilohet në 10 (dhjetë) kopje, 5 (pesë) prej të cilave janë në Anglisht dhe 5 (pesë) në Shqip. Në rast të ndonjë konflikti midis versioneve në gjuhë Angleze dhe Shqipe, versioni në Anglisht do të jetë mbizotërues.

§ 57. Në lidhje me çështjet që nuk janë rregulluar në këtë Statut, do të zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

\* \* \* \* \*

Unë Noteri pasi lexova këtë Statut me zë të lartë Palëve të pranishme, jam e bindur se palët e gjejnë atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë dhe e firmosin lirisht para meje, dhe unë Noteri e vërtetoj atë sipas ligjit.

## AKSIONARËT


**Raiffeisen Bank sh.a.**

**Z. Steven Grunerud**




**Raiffeisen - Leasing International Gesellschaft m.b.H.**

**Znj. Rudina Ziu**



**NOTERE**

**Znj. Mimoza Sadushi**



**PERKTHYES**

**Znj. Edlira Cepani**

